



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit
P- 55
Prishtinë, më 26 shkurt 2016

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 26 SHKURT 2016**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 104 deputetë dhe i deklaroi të hapura punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të grupeve të deputetëve.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

* * *

Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 27 të Rregullores së Kuvendit, për President të Republikës së Kosovës janë nominuar dy kandidatë:

1. Z. Hashim Thaçi dhe
2. Z. Rafet Rama.

Ai në vazhdim i ftoi propozuesit që para deputetëve të Kuvendit të paraqesin arsyetimin për kandidatët e nominuar për president:

Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, në emër të grupit të deputetëve, paraqiti arsyetimin për kandidatin e nominuar për president, z. Hashim Thaçi.

Ndërsa, deputetja Ganimete Musliu, në emër të grupit të deputetëve, paraqiti arsyetimin për kandidatin e nominuar për president, z. Rafet Rama.

Fjala e deputetëve Adem Grabovci dhe Ganimete Musliu, është dhënë e plotë në transkript.

Në vazhdim, kryetari propozoi që për verifikimin e kushteve të kandidatëve të nominuar për President, Kuvendi të autorizojë Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit.

Kryetari kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal të deklarohen për autorizimin e këtij komisioni.

Deputetët e miratuan propozimin e kryetarit që Kuvendi të autorizojë Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, për verifikimin e kushteve të kandidatëve të nominuar për President.

Kryetari kërkoi nga ky Komision që menjëherë të mblidhet në sallën N-303 dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin.

Kryetari caktoi një pauzë prej 15 minutave.

* * *

Pas pauzës, deputetja Selvije Halimi, në emër të këtij komisioni, para Kuvendit paraqiti raportin dhe konstatoi se kandidatët e nominuar për President, i plotësojnë të gjitha kushtet, të parapara me dispozitat ligjore, për President të Republikës së Kosovës.

Fjala e deputetes Selvije Halimi është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari hapi debat lidhur me propozimet e grupeve të deputetëve, për kandidatët e nominuar për president të Republikës së Kosovës.

Për këtë çështje diskutuan deputetët: Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të GP të AAK-së, dhe Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”, si dhe Melihate Tërmerkolli, Daut Haradinaj, Adem Grabovci, Ismajl Kurteshi, Fatmir Limaj, Time Kadrijaj, Rexhep Selimi, Enver Hoti, Teuta Haxhiu, Albin Kurti, Ganimete Musliu, Pal Lekaj dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në kohën përderisa diskutonte nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, deputetët e opozitës hedhin gaz lotsjellës në sallë.

Më pas, kryesuesi Xhavit Haliti e caktoi një pauzë prej 10 minutave.

* * *

Pas pauzës, kryetari Kadri Veseli e njoftoi Kuvendin lidhur me mbajtjen e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Fjala e kryetarit Kadri Veseli është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari më pas i vazhdoi punimet e seancës së jashtëzakonshme, duke e njoftuar Kuvendin me procedurën për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës.

Në ato momente deputetët e opozitës përsëri hedhin gaz lotsjellës në sallë.

Kryetari caktoi përsëri një pauzë prej 10 minutave dhe caktoi takim të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

* * *

Pas pauzës, kryetari Kadri Veseli e njoftoi Kuvendin lidhur me mbajtjen e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Fjala e kryetarit Kadri Veseli është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari, para se të vazhdojë procedimin me këtë pikë të rendit të ditës, në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës i uroi z. Adem Demaçit, simbolit të rezistencës shqiptare, 80-vjetorin e lindjes.

Në vazhdim, ai i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Grupet Parlamentare i propozuan këta anëtarë:

1. Selville Halimi, GP PDK,
2. Njomza Emini, GP LDK,
3. Ilir Deda, GP “Vetëvendosje”,
4. Sasha Milosavljeviq, GP LS,
5. _____, GP AAK,
6. _____, GP “Nisma” dhe
7. Danush Ademi, GP “6+”.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Selville Halimi. Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 81 deputetë dhe rezultati i votimit është, si në vijim:

Për Hashim Thaçin votuan 50 deputetë,
Për Rafet Ramën votuan 4 deputetë dhe
Të pavlefshme janë 27 fletëvotime.

Ajo konstatoi se Kuvendi duhet ta përsërisë votimin me dy kandidatët në rundin e dytë.

Rundi II

Deputeti Ilir Deda, siç tha ai, deklaroi se grupet parlamentare opozitare kanë kërkuar nga ai që të mos jetë pjesë e Komisionit votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Selvije Halimi. Ajo konstatoi se në votim në rundin e dytë morën pjesë 81 deputetë dhe rezultati i votimit është, si në vijim:

Për Hashim Thaçin votuan 64 deputetë,
Për Rafet Ramën votuan 2 deputetë dhe
Të pavlefshme janë 15 fletëvotime.

Ajo konstatoi se Kuvendi duhet ta përsërisë votimin me dy kandidatët në rundin e tretë.

Rundi III

Deputeti Fisnik Ismajli propozoi që në rundin e tretë të votimit për president, deputeti Ilir Deda të jetë pjesë e Komisionit votues, në emër të grupeve parlamentare opozitare.

Deputeti Hajdar Beqa propozoi që seanca të deklarohet me votim se deputeti Ilir Deda nuk mund të propozohet në emër të grupeve parlamentare opozitare, por vetëm në emër të GP “Vetëvendosje”.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Hajdar Beqa.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e lartpërmendur të deputetit Hajdar Beqa.

Pastaj deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Selvije Halimi. Ajo konstatoi se në votim në raundin e tretë morën pjesë 81 deputetë dhe rezultati i votimit është, si në vijim:

Për Hashim Thaçin votuan 71 deputetë.
Për Rafet Ramën votuan 0 deputetë dhe
Të pavlefshme janë 10 fletëvotime.

Ajo konstatoi se Kuvendi e zgjodhi z. Hashim Thaçin për President të Republikës së Kosovës, me mandat pesëvjeçar.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës

1. Z. Hashim THAÇI zgjidhet President i Republikës së Kosovës.
2. Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.

* * *

Kryetari, më pas, e ftoi Presidentin e sapozgjedhur të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, për një fjalë rasti.

Hashim Thaçi, pasi i falënderoi deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për besimin e dhënë, theksoi se kjo është një përgjegjësi më shumë për t'i shërbyer vendit, për t'u shërbyer të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ai i falënderoi ambasadorët për qëndrimin e tyre të vazhdueshëm gjatë tërë ditës, në një proces të zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës.

Ju siguroj se besimi juaj do të jetë një shpresë e re, një optimizëm i ri për Republikën e Kosovës.

Ju siguroj se do të punoj gjithmonë në shërbim të vendit, do të punoj gjithmonë në shërbim të gjithë qytetarëve, duke e respektuar gjithmonë Kushtetutën, duke e respektuar funksionimin e pavarur të institucioneve demokratike të vendit, duke punuar për rend dhe ligj, duke u shërbyer të gjithë qytetarëve, pa dallime etnike.

Do të jemi në shërbim të të gjithëve për ta ndërtuar Kosovën e re, për ta ndërtuar Kosovën evropiane, për të punuar edhe më fuqishëm për anëtarësimin e Kosovës në NATO, në Bashkimin Evropian dhe për t'i forcuar edhe më tepër marrëdhëniet tona të shkëlqyeshme e të përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Dëshiroj edhe një herë t'i falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që për një dekadë të tërë ma kanë besuar fuqinë më të madhe në vend.

Dëshiroj të ju falënderoj ju deputetë të nderuar të opinioneve të ndryshme politike për besimin tuaj.

Të jeni të sigurt se do të punoj edhe më fuqishëm në institucionalizimin e dialogut politik, si kusht i domosdoshëm për të ardhmen tonë stabile, në paqe, progres, zhvillim ekonomik dhe implementimin e të gjitha prioritetëve tona shtetërore.

Sot, në këtë moment madhështor dhe të veçantë, edhe për mua jetësisht, dëshiroj ta përkujtoj heroizmin e komandantit legjendar Adem Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të lirisë, të kujtoj me respektin dhe pietetin më të lartë për presidentin historik Ibrahim Rugova dhe të gjithë njerëzit që e dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, theksoi z. Hashim Thaçi.

* * *

Kryetari, në fund, theksoi se betimi i Presidentit z. Hashim Thaçi do të bëhet më 7 prill 2016, në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

* * *

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e jashtëzakonshme në orën 20:00.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi: Selman Ymeri,
zyrtar i lartë ligjor